

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SHTIME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	617-25-7750-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Renovimi i Gjimanzit Naim Frashëri ne Shtime**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

TRIANGLE SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

23000

(Kodi postar)

049 473 653

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ukë Baftjaraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

triangle.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

18.09.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftimi për kontrate i datës **25.08.2025**
2. Dosja e tenderit e datës **08.09.2025**
3. B54 Formulari standard për korigjim të gabimeve **08.09.2025**

Me datën 04.09.2025 kemi parashtruar Kërkesen për Rishqyrtim në AK, ku është refuzuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Zyra e prokurimit e Autoritetit Kontraktues KK Shtime me datën: **25.08.2025** ka publikuar njoftimin për kontratë për prokurimin me nr. të prokurimit dhe titull të lartcekur. Ne kemi shprehur interesim në lidhje me procedurën në fjalë me ç'rast kemi shkarkuar dosjen e tenderit. Pasi kemi analizuar dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë kemi vërejtur që Autoriteti Kontraktues kishte paraqitur kritere diskriminuese të cilat bien ndesh me legjislacionin e prokurimit. Të pa kënaqur me njoftimin e AK-s dhe me kriteret diskriminuese të cilat nuk ishin relevante me natyrën e projektit ne **me datën 04.09.2025 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit** me të cilën kemi kërkuar që: AK të shqyrtojë kërkesën tonë për rishqyrtim, të pezullon zbatimin e këtij aktiviteti të prokurimit, si dhe të nxjerrin:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik : TRIANGLE SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Renovimi i Gjimanzit Naim Frashëri në Shtim** me nr. të prokurimit: **617-25-7750-5-1-1** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **KOMUNA SHTIME**

NDRYSHOHEN DHE PËRMIRËSOHEN Kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njejtat të paraqiten në përshtatje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit.

Përndryshe do të detyrohem të paraqitja ankesë në Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Edhe pas dokumentimit të shkeljeve të cilat i ka bërë AK me fakte dhe prova, AK në mënyrë të kundërligjshme pa i marr për bazë provat e paraqitura me pretendimet tona, aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën tonë por nuk i largon shumicën e kritereve diskriminuese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe

nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka përgatitur dosjen e tenderit në pajtim me qëllimin dhe kërkesat ligjore të prokurimit publik, sepse tek kriteret e kapacitet profesional janë vendosur kërkesa jo relevante dhe me efekt avantazhi për të favorizuar OE që janë të identifikueshëm, dhe nga ana tjetër për të eliminuar konkurrencën e lirë në mesin e OE. Në këtë mënyrë janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-së dhe legjislacionit sekondar si më poshtë:

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së lidhur me parimet bazike nga neni 4.3 të Rregullave për Prokurim Publik;

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 6 pika (i), pika (iii) i LPP-së lidhur me parimet bazike 4.3 të Rregullave për Prokurim Publik

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatese te Rregullave te prokurimit publik.

Neni 17 paragrafi 12, dhe paragrafi 17 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 25.4 i Rregullave për Prokurim Publik lidhur me nenin 8 pika 3, pika 4 dhe pika 5 e Udhëzuesit Nr. 001/ 2023 për Prokurim Publik;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me njoftimin e dates **25.08.2025** mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Shtimes ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Renovimi i Gjimanzit Naim Frashëri ne Shtime** me nr. te prokurimit: **617-25-7750-5-1-1** dhe pas refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim në AK, duke pasur parasysh që ankesa jonë është

refuzuar si e pabazuar ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

Për shkak se AK- **KOMUNA SHTIME**:

- Ne mënyrë te kundërligjshme ka vendosur kriteret diskriminuese dhe favorizuese ne Njoftim per kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.)

Sqarojmë ne mënyrë te detajuar :

Pas analizimit në tëresi të përmbajtjes së dosjes së tenderit, kemi gjetur se, dosja e tenderit bie ndesh me parimet dhe kërkesat qenësore të prokurimit (barazia në trajtim/jo-diskriminimi) për arsye se tek kriteret e gjendjes ekonomike dhe financiare si dhe te kapacitetit teknik janë vendosur kërkesa jorelevante, kërkesa haptazi të përshtatura për OE të identifikueshëm, respektivisht që krijojnë disfavore dhe kufizojnë konkurrencën në dëm të operatorëve tjerë ekonomik në kundërshtim me nenin 7 lidhur me nenin 51 të LPP-së, nenin 17 të Rregullores. 001/ 2022 dhe nenin 8 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

Ne e shofim shume qarte qe keto kriteret jan diskriminuese dhe ju jemi drejtuar AK qe te hiqen ose te permisohen edhe pse AK ka prologuar me fjalen qe te perzgjedhim nje OE te pergjegjshem per perfundimin e kontrates pasi qe eshte projekt i rendesishem eshte per tu habitur se si keta me kriteret te njejta tashme ne projektin e katerte me radh e favorizojn vetem nje OE pra keta nuk jan te interesuar per te perzgjedhur nje OE te pergjegjshem por per te favorizuar, neve si OE kemi disa referenca te leshuara nga po ky AK pra ne jemi te pergjegjshem dhe ne po kerkojm vetem te mos ket kriteret diskriminuese.

Konkretisht bëhet fjalë për disa nga kërkesat e kapacitetit profesional që si të filla janë jo relevante me objektin e kontratës dhe krijojnë favore në dobi të njëres palë, respektivisht disfavore në dëm të OE tjerë e të cilat janë të vendosura në nenin **9.1 & 9.2** të FTD-së të dosjes të tenderit, të radhitura si më poshtë:

1.

9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:

b)Min Nje inxhinier i Arkitektures ose Ndertimtarise-Konstruktiv min 3 vite pervoje pune i certifikuar me (Licencen A) nga MMPHI, dhe i certifikuar si Auditor i energjise nga nje institucion i licencuar i Republikes se Kosoves.

Kjo kërkesë është e panevojshme duke e pare natyren e kontrates, ku me e nevojshme është te jete kerekesa per ixhinier te elektronikes apo makinerise gje qe është adekuat me natyren e kontrates. Nuk është relevante dhe nuk ka asnjë lidhje me objektin e këtij aktiviteti të prokuruar nga ana e AK-së, por si e tillë është e vendosur me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. - **Ne mendojm qe ky kriter duhet te hiqet apo edhe ndryshohet**

c)Min Nje Inxhinier I Ndertimtarise sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi Hidroteknik min 5 vite pervoje pune, I certifikuar me (Licencen A) nga MMPHI. Te jete i certifikuar per menaxhim te projekteve.

Kjo kërkesë qe inxhinieri i Hidroteknikes te jete kushtimisht edhe me çertifikate per menaxhim te projekteve është e pakuptimt se pse nje kerkese e tille, kur mundet te jete ixhinier i Hidroteknikes pa certifikata te precizuara, ku inxhinieri ne fjale permes CV se tij dhe referencave si deshmi pune e argumenton pervojen e tille per menaxhim te projekteve. Nje kerkese e tillë është e vendosur me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender, si mund te jet kerkese qertifikat e menaxhimit te projekteve ku ne kete kontrat 5% është pergjegjesi e inxhinierit te Hidroteknikes, andaj kerkojm nga ju te ja sqaroni edhe AK. - **Ne mendojm qe ky kriter duhet te hiqet apo edhe ndryshohet**

d)Min Nje Inxhinier I Makinerise sistemi 5 vjeqar ose (master) min 5 vite pervoje pune, I certifikuar me (Licencen A) nga MMPHI, te jete i certifikuar si Ekspert per siguri dhe shendet ne pune nga nje kompani e licencuar ne Republiken e Kosoves.

Kjo kërkesë qe inxhinieri i Makinerise te jete kushtimisht edhe me çertifikate si Ekspert per Siguri dhe Shendet ne Pune është e pakuptimt se pse nje kerkese e tille, kur mundet me qene nje inxhinier tjeter i profilit tjeter ku edhe sipas paramases dhe punes qe do te behen, vlera e pozicioneve te makinerise është me e vogel se vlera e pozicioneve te arkitektures, andaj pse është bere nje kerkese e tille, apo edhe jane pak njerez qe e kane kete certifikate. Nje kerkese e tillë është e vendosur me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të

diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. - **Ne mendojmë që ky kriter duhet të hiqet**

f)Min Nje Inxhinier i Ndertimtarise Master ose Bachelor drejtimi hidroteknik ose konstruktiv min 5 vite pervoje pune i certifikuar nga AME.

Kjo kerkese eshte bere qe te kufizohet kryekput pjesemarrja ne tenderin ne fjale, arsyerja eshte se pozicionet e Hidros kane vlere minore ne krahasim me vleren e kontrates, duke analizuar me thelle pse eshte kerkuar edhe nje inxhinier i Hidroteknikes ku edhe eshte kerkuar ne piken d), inxhinieri i Hidroteknikes gjithashtu eshte kerkuar te jete i certifikuar nga AME- Agjensioni i Menaxhimit Emergjent, ku AME leshon keto certifikata per personat qe do te trajnohen per rastet kunder zjarrit etj, mirepo duke e analizuar paramasen, asnje pozicion nuk eshte per punet qe do te behen kunder zjarrit duke instaluar hidrante apo edhe sistem te sprinklerave, andaj pse nje kerkese e tille. Kjo kerkese është e vendosur me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. Tashme kemi persona pergjegjes qe jane per menaxhimin e emergjencave- **Ky kriter duhet te hiqet (pasi qe me larte kemi si kerkese edhe inxhinier te hidroteknikes edhe konstruktiv)**

k)Min nje punetor i certifikuar per menaxhimin e pikave matese te energjise elektrike min 5 vite pervoje pune pas certifikimit.Te jete i certifikuar nga institucionet e Republikes se Kosoves, ose institucionet e akredituara te R. Se Kosoves.

Nje kerkese e tille eshte bere e panevojshme pasi qe ne teren jane 4 shtylla e pse duhet te jete nje kerkese e tille kaq specifike qe nje person te jete i qertifikuar per pika matese te energjise elektrike, ku ka plote kompani qe jane te akredituara qe e bejne kete pune dhe leshojn shqyrtimet apo elaboratet e pikave matese. - **Ky kriter duhet te hiqet**

Kerkesa 5. Paisjet teknike

2.Dumper vetshkarkues ne 3 anet I paisur me krah dhe luge per ngarkim min 4 ton.

Kjo kerkese eshte bere e panevojshme e komplikuar qe damperi te jete ne luge per 2 anet, ku nje damper normal I zakonshem e bene kete pune, pse pikerisht eshte cekur ne 3 anet ku asnje damper I zakonshem nuk I shenohet keshtu duke patur parasysh qe damperi me se shumti rekomandohet te perdoret ne terene jo te rrafshata dhe hapsirat te ngushta ku nuk

mund të hyn makinat tjera e në rastin e kontrates ka hapsira ku mund të perdoren edhe makinerit e tjera. Edhe kjo kerkese është vendosur me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurrenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet të hiqet ose permisohet**

4) Cilinder për ngjeshje Max. 1 T = min 1 copë,

Kjo kerkese është bërë qëllimisht pasi që dihet e ka një OE, sepse po të ndalemi të analizojmë paramaset të punës së zhavorit pos 1.03.01-1.03.03 ku thuhet se rezultati i ngjeshjes së zhavorit duhet të jetë $M_v > 50 \text{ daN/cm}^2$, një cilindër i kerkuar nga AK max 1 T nuk mundet të arrijë ngjeshjen e kerkuar sipas punëve të paramasës dhe parallogarise, mirepo do të duhet të jetë cilindër mbi 10 ton, andaj një kerkese e tillë është bërë me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurrenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet të hiqet ose permisohet**

5) Gjysëmrimorkio speciale me dy pompa për debllokimin e kanalizimeve me presion minimum 200 bar kapacitet 5000 litra min 1 copë.

Kjo kerkese është bërë qëllimisht pasi që dihet e ka një OE, si dhe pse është kerkuar në kriterin e tillë ku në asnjë pozicion të paramasës dhe parallogarise nuk ka pozicione të deblllokimit të kanalizimit apo vetëm se e ka ky OE është bërë kerkesa, andaj një kerkese e tillë është bërë me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurrenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet të hiqet ose permisohet**

7) Makinë mbjellëse e barit për drejtim të hapsirave të caktuara = min 1 copë.

Gjithashtu kjo kerkese është bërë e panevojshme sepse lloji i barit që do të mbillet nuk ka nevojë për makinë mbjellëse sepse mund të deshtojë një punë e tillë, andaj një kerkese e tillë është bërë me qëllim që të ulët dhe kufizohet konkurrenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet të hiqet ose permisohet**

8) Eskavator robotik i cili punon me energji elektrike dhe funksionon me telekomand I paisur me qekan dhe gersher per demolime max 500 Kg min 1 cope.

Kjo kerkese eshte aq specifike e panevojshme qe nje paisje te kete 4 karakteristika te punes, sidhe duke analizuar pozicionet e kontrates vetem nje pozicion eshte te punet e demolimit pos 1.04.09 ku thuhet se do te prehet betoni se bashku me armature ne menyre precize, andaj pse kerkesa eshte jo relevante me natyren e kontrates, andaj nje kerkese e tille eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

9) Cilinder me dhembeza I paisur edhe me luge per nivelizim te zhavorit max 4 ton min 1 cope.

Gjithashtu kjo kerkese eshte jo relevante me natyren e kontrates ku edhe shenuam ne piken 4) andaj nje kerkese e tille eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

11) Makine per shpime horizontale nen rruge min 2 cope

Kjo kerkese eshte jashte natyres se kontrates dhe po besojme se eshte vendosur vetem pse i ka OE ne fjale, sepse po te analizojme paramasen dhe parallogarine shihet qe nuk ka asnje pozicion te punes qe do te kryhet me kete paisje, andaj nje kerkese e tille eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

12) Prerese per beton dhe asfalt min 3 cope

Kjo kerkese eshte jashte natyres se kontrates sepse po te analizojme paramasen dhe parallogarine shihet qe nuk ka asnje pozicion te punes qe do te kryhet me kete paisje, andaj nje kerkese e tille eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen

dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

13). Makine hidraulike qe vendoset ne eskavator per hapjen e kanalit me system zingjiror min 1 cope.

Gjithashtu kjo kerkese eshte e panevojshme , po te verifikohet paramasa dhe parallogaria do te shihet se nuk ka asnje pozicion te punes qe do te kryhet me kete paisje, as te pozicionet e germimit per kanale apo edhe te pozicionet e kanlizimit dhe ujesjellesit, andaj nje kerkese e tille eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

14)Gjysem rimorkio per kositjen dhe bluarjen e barit me grumbullim gjate kositjes me kapacitet te rezervarit min 4m3 min 1 cope.

Nje kerkese e tille e bere nga AK eshte e panevojshme me gjithë keto karakteristika ku eshte vetem nje pozicion i barit normal dhe nuk duhet te jete aq specifike pasi qe nuk eshte duke u ndertuar ndonje stadium i futbollit ku duhet te jene specifikat e barit sipas EU, mendojme se ndonje paisje me e thjeshte mund te kryej kositjen e barit . **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

15).Kositese speciale qe montohet ne traktor per ledina dhe parqe min 8 kosa rrethore min 1 cope

Eshte e pakuptimit ne kriterin 14) eshte kerkuar kositjsja e barit si dhe ne kete kriter. Ky kriter eshte vendosur ne kundërshtim dhe lokacionin ku do te kryhen punet ku dihet se nuk ka hapësirë të mjaftueshme ku mundet te kryej punet kjo makineri. Duke e pare pozicionin e barit i cili eshte ne vlere te vogel me natyren kontrates te jene keto kerkesa per kositese te barit. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

16) Burgi hidraulike qe montohet ne eskavator per shpimin e vrimave vertikale per mbjelljen e drunjeve min 400 kg min 1 cope.

Gjithashtu kjo kerkese eshte e panevojshme sepse drunjet qe do te mbillen nuk kerkojne ndonje makineri te tille te punes aq specifike e qe jane shume te rralla, gjithashtu duke pare

natyren e kontrates per renovim te objektit nje kerkese e tille eshte deskriminuese. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

18) Kamion Kiper me vinc dhe korpe me kapacitet min 10 m³, vinci me hapje min 20 m (te deshmohet me atest ose pelqim gjatesia e kranit)min 1 cope

Ne pergjithesi ne baz te gjitha analizave te bera dhe hulumtimeve mund te gjesh kamion me korp me gjatesi deri ne 20m' dhe ata jane shume te rrall por jo kamion kiper me vinq me hapje 20 metra gjatesi eshte kriter i cili duhet analizuar dhe duhet te hiqet duke e marrur edhe faktin qe lartesia ma e madhe ne objektin e tregut eshte max 7m pra ky kamion eshte vendosur vetem sa per te kufizuar konkurencen mirpo jo per te sherbyer per kete projekt.

Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet

20) Kompresor gjysmerimorkio qe terhiqet min 1.5T = min 1 copë,

Kjo kerkese nuk është relevante dhe as proporcionale me objektin e kontratës sepse nuk përputhet me asnjë pozicion që lidhet me Llojet e punimeve të përfshira në pozicionet e kontrates andaj nuk e kuptojm pse eshte bere nje kerkese e tille edhe nuk mund te perdoret peshe specifike. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

21) Luge Ngarkuese max 3 ton min 1 cope.

Edhe kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. Kerkesa e tille e ngarkuese perdoret ne projektet me rruge te rendesise se veqante, nuk e kuptohet se pse ngarukesi te jete ne punishte ne renovimin e objektit. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet ose permisohet**

22) Automikser vetngarkues per prodhim betoni me pesh bartese max 4 ton min 1 cope.

Kjo kerkese nuk është e panevojshme pasiqe kualiteti i betonit nuk arrihet sipas klases se kerkaur, mirepo betoni duhet te sillet nga fabrika permes makinerise se saj, andaj eshte e panevojshme nje kerkese e tille. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet**

26) Kamionete kipper me pesh bartese max 1 ton min 1 cope.

Eshte e panevojshme nje kamionete e tille me sasi bartese aq te vogel ku munden te kerkohen kamion te ndryshem me pesha mesatare apo me te medhaja duke i pare sasite e germimt dhe sasite e zhavorit per kete projekt. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet**

27) Traktor 4x4 max 1.5 T me kositese te barit dhe rezerave per mbledhje te barit gjate kositjes min 2m3. min 1 cope.

Gjithashtu pse te kerkohet nje traktor i tille per mbledhje dhe kositje dhe jane kerkuar edhe me larte makineri per kositese ne pikat 14) dhe 15), siq e sqaruam me larte eshte e panevojshme nje kerkese e tille pasiqe nuk perkon me natyren e kontrates dhe eshte jo relevante nje kerkese e tille, andaj kjo kerkese eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet**

28) Gjysemrimorkio gjenerator max 1 ton min 1 cope.

Eshte e panevojshme nje kerkese e tille pse te kerkohet gjenerator gjysemrimorkio kur punen mund te kryej nje gjenerator i zakonshem qe e kane shumica e OE, andaj kjo kerkese eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet**

29) Greder max 5 ton min 1 cope.

Kjo kerkese eshte e panevojshme sepse puna ku do te kryhet nuk eshte vend i zakonshem per greder andaj eshte i panevojshme, ku gredri perdoret ne rruge e lokacione te hapura, andaj kjo kerkese eshte bere me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet**

30) Dumper vetshkarkues ne 3 anet min 5 ton.

Kjo kerkese eshte bere e panevojshme e komplikuar qe damperi te jete veteshkarkues per 3 anet, ku nje damper normal I zakonshem e bene kete pune, pse pikerisht eshte cekur ne 3 anet ku asnje damper I zakonshem nuk I shenohet keshtu. Edhe kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të

favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet**

31) Eskavator 13-15 ton min 1 copë

Kjo kerkese si e tillë është e vendosur me qëllim që të ulet dhe kufizohet konkurenca e lirë në mënyrë që përmes këtij kriteri të favorizohet një OE i caktuar, kurse nga ana tjetër të diskriminohen dhe pengohen OE tjerë që duan të marrin pjesë në këtë tender. Kufizimi i tonazhes është precedent që ky kriter është vendosur qëllimshëm. **Edhe kjo kërkesë duhet te hiqet apo duke përdorur maksimumet dhe minimumet.**

KERKOJM NGA PANELI SHQYRTUES QË TA TRAJTOJ KETË LENDË DHE TË OBLIGOJ AK TË BËJË KORIGJIMIN E DT. JEMI TË VETEDIJSHËM QË LEJOHEN MARRVESHJET EDHE PËR INXHINIER EDHE PËR MAKINERË PËR KETË PROJEKT PRA PAJTOHEMI ME ATË QË E KA THËNË AK MIRPO NJË GJË DUHET TA KETË PARASYSH AK QË KETË KRITERË I POSEDON VETËM VETËM ATË TË CILËT I KA FAVORIZUAR AK.

Ne mendojmë që këto kritere diskriminuese të njëjta pothuajse edhe në dy projektet e vitit të kaluar janë projektet të cilat po e favorizojnë vetëm një kompani dhe po na pamundësojnë të drejtën për ofertim, projektet me kritere identike kanë qenë edhe projektet si më poshtë:

Titulli: Rregullimi i Tregut të Hapur në Qytetin e Shtimes-Faza II nr prokurimi :617-23-10784-5-2-1

Titulli: Ndërtimi i objektit të Komunës nr prokurimi: 617-24-964-5-1-1

Pas kërkesës për rishqyrtim AK me kritere identike e ka publikuar tashmë edhe një kontratë:

Titulli: Ndërtimi i sallës së sportive në shkollë në Rashinc dhe Zborc nr prokurimi : 617-25-8388-5-2-1

Në këtë mënyrë nga ana e AK-së janë shkelur një mori dispozitash ligjore të ndara, të lidhura dhe të varura me njëra tjetrën, që i kanë kushtuar rëndësi të veçantë parimeve dhe mënyrës së përcaktimit të kritereve/kërkesave minimale për kualifikim për t'i mundësuar AK që të verifikojë se OE i posedon aftësitë e nevojshme kualifikuese nga neni 65-70 të këtij ligji, duke i kufizuar që të jenë:

relevante/nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, që nuk mund të kenë peshë të caktuara, që nuk kufizojnë konkurrencën në mes OE, dhe që nuk janë diskriminuese kundër ose në favor të një ose më shumë OE.

Po ashtu është shkelur edhe neni 25.4 i Rregullores për prokurim publik i cili me rastin e përcaktimit të kriterëve obligon AK-në që t'i kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe të formuloni kërkesa minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE e themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe teknike.

Mirëpo, siç dëshmohet nga rrethanat faktike dhe ligjore, rezulton se nga ana e AK-së shkilen në mënyrë flagrante/arbifrare detyrimet ligjore, sepse kriteret e përzgjedhjes të vendosura në këtë aktivitet janë bazua në konsideratë tjera e jo në parimet bazike dhe kërkesat ligjore të prokurimit publik nga nenet 1, 7, 51 të LPP-së; 17.17 dhe 25.4 të RRPP Nr.001/2023 dhe neni 8 UPP 001/2023.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK që ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : TRIANGLE SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Renovimi i Gjimanzit Naim Frashëri në Shtime** me nr. të prokurimit: **617-25-7750-5-1-1** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Shtimes.

Urdhërohet Autoriteti Kontraktues që të NDRYSHOHEN DHE PËRMIRËSOHEN Kërkesat e lartcekura dhe të njëjtat të paraqiten në përshtatje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit duke hequr kriteret diskriminuese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues si më lartë, në konsiderojmë që AK na ka bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e e kërkesës për rishqyrtim dhe kësaj ankese për shkak se ka paraqitur kriterë diskriminues dhe jo proporcionale me qëllimin e kontratës. Gjithashtu do të na pamundësohet konkurrimi në këtë procedurë të prokurimit edhe pse ne jemi të specializuar për kryerjen e punëve që kërkojnë në specifiat teknike.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.